



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Companya Eskavatori" Sh.P.K. të datës 12.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve në lagjen "Hajvalia"" me nr. të prokurimit 616-25-6971-5-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Companya Eskavatori" Sh.P.K. të datës 12.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve në lagjen "Hajvalia"" me nr. të prokurimit 616-25-6971-5-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Companya Eskavatori" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 12.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve në lagjen "Hajvalia"" me nr. të prokurimit 616-25-6971-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritorum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Andaj, OE "Companya Eskavatori" sh.p.k., parashtron këtë kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit për Kontratë – respektivisht kundër kriterëve të dosjes së tenderit në Aneksin 8 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme lidhur me aktivitetin e prokurimit me numër 616-25-6971-5-1-1 "Ndërtimi i rrugëve në lagjen „Hajvalia"

1. AK Komuna e Prishtinës me dosjen e tenderit, respektivisht Aneksin 8 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme ka specifikuar Llojin e Pajisjes, sasinë dhe ka përcaktuar rubrikën e të dhënave për pajisjet duke kërkuar që për të gjitha pajisjet që regjistrohen duhet të kenë regjistrim valid, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, DUD-at, faturat e blerjes, librat e regjistrimit etj.
2. OE "Companya Eskavatori" konsideron se Aneksi 8 – Pajisjet e nevojshme, respektivisht kërkesat në të janë të ekzagjeruara dhe diskriminuese. Në një rrugë me gjatësi 2,100 janë kërkuar gjithsejt 66 pajisje, nga pajisjet e kërkuara shumica prej tyre nuk kanë të bëjnë fare me pozicionet që janë në paramasë psh. pika 27 kamion me fshisë që posedon spërkatës për emulzion, pika 28 makinë për shpërndarjen e bitolitit, Pika 29, 30 gërryese të asfaltit, pika 42 makinë për montimin e kubëzave (në paramasë nuk kërkojnë spërkatja me emulzion, bitolitit, gërryerja e asfaltit, montim i kubëzave) prandaj duke u bazuar në paramasë siç e kemi cekur edhe me lartë mjetet e kërkuara janë ekzagjeruar, pasi që ky nuk është projekt i ndërtimit të ndonjë autostrade po është projekt i ndërtimit të rrugëve lokale këto pajisje dhe shumë tjera duhet të fshihet nga lista.
3. Gjithashtu tek Kapaciteti teknik dhe profesional pika 9.1 & 9.2 është kërkuar Inxhinier për menaxhim të pronave, Konsiderojmë se ky kusht nuk është në përputhje me natyrën e punimeve të projektit, për këto arsye:

3.1. Profili i punimeve në këtë tender është ndërtim i rrugës, ku pozicioni i një eksperti të certifikuar në GIS dhe diplomuar në menaxhim të pronave nuk paraqet funksion thelbësor teknik në procesin e ndërtimit, mbikëqyrjes dhe zbatimit të punimeve të infrastrukturës rrugore.

3.2. Funksionet e GIS-it dhe menaxhimit të pronave nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me procesin e ndërtimit të rrugës, dhe sipas praktikave të mira të prokurimit publik,

kërkesat për staf duhet të jenë të arsyetuara, proporcionale dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

4. Siç shihet AK Komuna Prishtinës këto mjete i ka kufizuar në madhësi duke përcaktuar minimumin ose maksimumin e peshës së tyre në ton. Ky kufizim vlerësojmë se është bërë për të pamundësuar konkurrencën dhe rrjedhimisht këto kërkesa janë bërë me qëllim të favorizimit të një operatori ekonomik në dëm të operatorëve të tjerë ekonomik, e që natyrisht kjo pamundëson të ketë konkurrencë në këtë aktivitet të prokurimit, e që mos ekzistimi i konkurrencës bën që të dëmtohet edhe buxheti i Kosovës për këtë aktivitet të prokurimit, sepse mungesa e konkurrencës bën që operatori ekonomik i cili eventualisht i plotëson këto kritere siç janë aktualisht të ofertoj me një çmim shumë të lartë dhe rrjedhimisht të shpallet fitues në mungesë të konkurrencës nga operator të tjerë të cilët do të ofertonin me çmime më të ulta nëse këto kritere diskriminuese ndryshohen,

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë shqyrtuar dhe me këtë rast është gjetur se këto pretendime janë të pabazuara në kuptim të kësaj kërkesë për rishqyrtim, pasi që të gjitha pajisjet janë absolutisht të domosdoshme për realizimin efikas dhe efektiv të projektit. Vlen të shtohet se AK me dt. 11.08.2025 e ka korrigjuar DT duke eliminuar përfundimisht të gjitha kërkesat për të cilat mund të dyshohen si diskriminuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.08.2025


Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.